



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 281, Datë 25.09.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT TË ERE-S, PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET (BARRË
SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/5prot., datë 21.09.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga “ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Cerem” dhe “Dragobi”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2016 dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.04.2021.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.08.2023, i licencuari “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. dhe ortaku i vetëm i saj/koncesionari “GENER 2” sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të Shoqërisë Koncesionare “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palëve të treta, konkretisht ndaj shoqërive “BANKA

AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a., “BANKËS E TIRANËS” sh.a. dhe “UNION BANK” sh.a.

- ERE me shkresën nr. 2048/2 prot., datë 07.09.2023 i është drejtuar shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. duke evidentuar dokumentacionin e konstatuar të munguar, të këtij aplikimit. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048/3 prot., datë 11.09.2023, shoqëria ka depozitur në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Rezulton se shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., plotëson kërkesat si vijon:
 - **Neni 8, pika 1**, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.
 - **Neni 8, pika 2**, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.

Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. si mjet (barrë siguroese), për garantimin e detyrimit ndaj shoqërive “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a., “BANKËS SË TIRANËS” sh.a. dhe “UNION BANK” sh.a.
2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe organeve të tjera përkatëse nëse kërkohet sipas akteve ligjore ne fuqi në çdo moment qe ndodh transferimi.
3. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjes së barrës siguroese mbi kuotat e saj.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k., shoqërinë Gener 2 sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI